



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-060

PËR MJEKËSINË LIGJORE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MJEKËSINË LIGJORE

KREU I
DISPOZITAT PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i procedurës për kryerjen e ekzaminimeve mjeko ligjore, themelimi dhe veprimtaria e Institutit për Mjekësinë Ligjore (në tekstin e mëtejme Instituti)

Neni 2
Përkufizimet

1. Për qëllimet e këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1.1. **Ekzaminimi Mjeko Ligjor** - procedurë mjeko ligjore që konsiston në ekzaminimin e kufomës, personave të gjallë, provave materiale biologjike, dhe ekzaminimet tjera mjeko ligjore;

1.2. **Autopsia Mjeko Ligjore** - procedurë e ekzaminimit mjeko ligjor që konsiston në ekzaminimin e jashtëm dhe të brendshëm të kufomës apo të mbetjeve mortore për

përcaktimin e shkakut, mekanizmit, mënyrës së vdekjes, dhe rrethanave të tjera që kanë të bëjnë me vdekjen;

1.3. **Ekzaminimi Klinik Mjeko Ligjor** - procedurë e ekzaminimit mjeko ligjor që përfshin ekzaminimin klinik të personave të gjallë në raste të lëndimeve fizike, cenimit të integritetit seksual, si dhe ekzaminimeve tjera klinike mjeko ligjore.

1.4. **Ekzaminimi i Provave Materiale Biologjike** - procedurë e ekzaminimit mjeko ligjor që përfshin ekzaminimin e gjakut, spermës, qimeve, eshtrave, dhembeve, indeve ose pjesë organesh, pështymës, djersës, urinës, dhe indeve të tjera trupore për qellime mjeko ligjore.

1.5. **Raporti i Ekzaminimit Mjeko Ligjor** - akt mjeko ligjor që hartohet nga eksperti mjeko ligjor pas ekzaminimit mjeko ligjor, e që nënkupton raportin e autopsisë mjeko ligjore, raportin e ekzaminimit klinik mjeko ligjor, raportin e ekzaminimit të mostrave trupore biologjike, si dhe raportin e ekzaminimeve të tjera mjeko ligjore;

1.6. **Certifikata e Vdekjes** - dokument mjeko ligjor, që përmban përveç tjerash kohën, vendin, dhe shkakun e vdekjes, për rastet të cilat i nënshtrohen autopsisë mjeko ligjore;

1.7. **Eksperti Mjeko Ligjor** - specialist i licencuar në fushën e mjekësisë ligjore i cili kryen ekzaminime mjeko ligjore;

1.8. **Shërbyes Shëndetësor** – punonjës i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë merr pjesë në kryerjen e punëve dhe detyrave lidhur me ekzaminimin mjeko ligjor në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.9. **Nenpunës Civil** - punonjës i cili në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë kryen punë dhe detyra lidhur me ekzaminimin mjeko ligjor në pajtim me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil;

1.10. **Toksikologjia Mjeko Ligjore** - ekzaminimi apo analiza e materieve të dyshimta, përkatësisht mostrave trupore të gjetura në kufomë dhe në rastet tjera të ekzaminimeve mjeko ligjore tek personat e gjallë.

1.11. **Histopatologjia Mjeko Ligjore** - ekzaminimi mikroskopik i mostrave të marra nga indet apo organet me qëllim të përcaktimit të shkakut të vdekjes;

1.12. **Biologjia Mjeko Ligjore** - marrja dhe analiza e mostrave biologjike gjatë ekzaminimeve mjeko ligjore;

1.13. **Antropologjia Mjeko Ligjore** - aplikimi i teknikave standarde antropologjike për analizimin e mbetjeve mortore-eshtrave të njeriut në aspektin mjeko ligjor dhe/ose humanitar;

1.14. **Arkeologjia Mjeko Ligjore** - aplikimi i teknikave standarde arkeologjike në aspektin mjeko ligjor dhe/ose humanitar;

1.15. **Odontologjia Mjeko Ligjore** - aplikimi i njohurive dentare në aspektin mjeko ligjor dhe/ose humanitar.

KREU II EKZAMINIMET MJEKO LIGJORE

Neni 3 Kryerja e Ekzaminimeve Mjeko Ligjore

1. Ekzaminimet mjeko ligjore, si: autopsia mjeko ligjore, ekzaminimi klinik mjeko ligjor, ekzaminimi i mostrave biologjike, si dhe ekzaminimet tjera mjeko ligjore të parapara me ligj kryhen nga ekspertët mjeko ligjor të Institutit.
2. Ekspertët mjeko ligjor kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive, të pavarur, të paanshme dhe duhet t'u përmbahen parimeve të fshehtësisë profesionale lidhur me informatat e mbledhura, analizat dhe të gjeturat tjera për të cilat mësojnë gjatë kryerjes së detyrës dhe praktikave jo diskriminuese, në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore përkatëse.
3. Eksperti i mjekësisë ligjore e kryen ekspertimin në pajtim me ligjin, me urdhër të Gjykatës apo të Prokurorit të Shtetit.
4. Nëse në Institut nuk ekziston ekspertiza përkatëse, eksperti përkatës angazhohet dhe kompensohet nga fondet publike.

Neni 4 Vendi i Kryerjes së Ekzaminimeve Mjeko Ligjore

1. Ekzaminimet mjeko ligjore të parapara në nenin 3 të këtij ligji kryhen në lokalet përkatëse të Institutit.
2. Gjykata apo Prokuroria e Shtetit mund të urdhërojë kryerjen e ekzaminimeve mjeko ligjore jashtë lokaleve përkatëse të Institutit pasi që të sigurohen kushte të përshtatshme për një gjë të tillë.

Neni 5 Autopsia Mjeko Ligjore

1. Autopsia mjeko ligjore, në pajtim me ligjin dhe dispozitave përkatëse, kryhet por nuk kufizohet në këto raste:
 - 1.1. vrasja ose vrasja e dyshimtë;
 - 1.2. vdekja e papritur dhe në rrethana të paparashikueshme, duke përfshirë edhe vdekjen e papritur të foshnjave;

- 1.3. cenimi i të drejtave të njeriut siç është dyshimi për torturë ose për çfarëdo lloj të keqtrajtimit;
- 1.4. vetëvrasja ose dyshimi në vetëvrasje;
- 1.5. dyshimi në mjekim të pandërgjegjshëm;
- 1.6. aksidentet, si ato rrugore, profesionale ose në amvisëri;
- 1.7. sëmundjet profesionale;
- 1.8. fatkeqësitë teknologjike ose mjedisore;
- 1.9. vdekja në arrest ose vdekja e ndërlidhur me aktivitete policore ose ushtarake;
- 1.10. trupat e paidentifikuar ose të skeletizuar.

Neni 6 **Ekzaminimi Klinik Mjeko Ligjor**

1. Ekzaminimi klinik mjeko ligjor kryhet por nuk kufizohet në:

- 1.1. përcaktimin e mjetit, shkallën e lëndimeve trupore, humbjen e aftësisë për punë, gjendjen shëndetësore, simulimin, vetëdëmtimin;
- 1.2. rastet e veprave penale kundër integritetit seksual të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi;
- 1.3. rastet e përcaktimit të moshës dhe identitetit të një personi, të shkallës së dehjes alkoolike dhe intoksikimit me lende narkotike;
- 1.4. rastet e transplantimit të kundërligjshëm të organeve, indeve dhe qelizave njerëzore.

2. Ekzaminimi klinik mjeko ligjor duhet të kryhet te viktima dhe i dyshuari.

3. Ekzaminimi klinik mjeko ligjor duhet të kryhet vetëm pasi të informohet i ekzaminuari për natyrën e ekzaminimit që duhet të kryhet dhe pas marrjes së pëlqimit vullnetar nga i ekzaminuari.

4. Në rast të refuzimit për dhënie të pëlqimit nga paragrafi 3 i këtij neni zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 7

Afati për kryerjen ekzaminimeve mjeko ligjore dhe përfundimi i raportit mjeko ligjor

1. Ekzaminimet mjeko ligjore, duhet të kryhen brenda afateve të arsyeshme kohore, si në vijim:

1.1. autopsia mjeko ligjore, nuk mund të fillohet me herët se gjashtë (6) orë nga momenti i konstatimit të vdekjes;

1.2. analizat toksikologjike apo analizat tjera duhet të përfundohen brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve apo më së largu gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për këto analiza;

1.3. në rastet të veçanta kufizimi i afatit të përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të këtij neni mund të zgjatet pas miratimit me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit.

2. Raporti mjeko ligjor për gjetjet nga paragrafi 1 i këtij neni, në pajtim me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, duhet të përfundohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të rezultateve të analizave.

Neni 8

Varrimi, lirimi i kufomës dhe i gjësendeve personale

1. Pasi të jetë kryer autopsia, kufoma, pjesët e trupit dhe mbetjet mortore të identifikuar u kthehen anëtarëve të familjes në rast se nuk ekziston nevoja për ekzaminime të mëtejme mjeko ligjore.

2. Në raste të jashtëzakonshme si në vijim, Instituti sipas urdhërit nga Gjykata apo Prokurori i Shtetit, kërkon nga organet kompetente kryerjen e ceremonisë mortore:

2.1. nëse kufoma apo pjesët e trupit nuk janë identifikuar pas kryerjes së autopsisë dhe pas kryerjes së të gjitha procedurave tjera identifikuese;

2.2. nëse nuk ka anëtar të familjes që ta pranojnë kufomën apo pjesët e trupit;

2.3. nëse anëtarët e familjes refuzojnë ta marrin kufomën e identifikuar apo pjesët e trupit;

2.4. nëse për çfarëdo arsye nuk është e mundur t'i kthehet anëtarëve të familjes kufoma apo pjesët e trupit për varrim.

3. Instituti i dorëzon Policisë çfarëdo gjësendi që gjendet në trupin e kufomës duke përfshirë rrobat dhe gjësendet personale, të cilat nuk janë mbledhur më parë nga policia në vendin e ngjarjes.

Neni 9

Procedurat e ekzaminimeve mjeko ligjore

Ekzaminimet mjeko ligjore kryhen në pajtim me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore të cilat i nxjerr Ministri i Drejtësisë në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

Neni 10

Shpenzimet e ekzaminimeve mjeko ligjore

Shpenzimet e ekzaminimeve mjeko ligjore bien në barrë të organit me urdhrin e të cilit është kryer ekzaminimi.

Neni 11

Fshehtësia e informatave

1. Informatat e mësura gjatë kryerjes së ekzaminimeve mjeko ligjore janë të fshehta për opinionin.
2. Zbulimi i informatave të parapara me paragrafin 1 të këtij neni mund të bëhet publike pas urdhrin të lëshuar nga gjykata apo prokurori i shtetit.
3. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga Instituti duhet të përdoren në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjin për klasifikimin e informacionit.

Neni 12

Obligimet e organeve hetimore dhe gjyqësore për ekzaminimet mjeko ligjore

1. Kur gjykata apo prokurori i shtetit nxjerr vendim për angazhimin e ekspertit përkatës të Institutit, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duhet t'i siguroj përkatësisht t'i ofroj ekspertit të Institutit, qasje në provat e duhura për ekspertimin e duhur profesional apo teknik.
2. Instituti duhet të merr në ruajtje trupin e vdekur, rrobat, mostrat biologjike dhe të gjitha provat që ndërlidhen me ekspertimin mjeko ligjor, përveç provave tjera forenzike të cilat janë obligim i organeve tjera kompetente.

Neni 13

Rrezikshmëria dhe orari i punës

1. Nëpunësit e Institutit të cilët në mënyrë të drejtpërdrejt apo jo të drejtpërdrejt marrin pjesë në ekzaminimet mjeko ligjore, për shkak të natyrës së punës, kanë të drejtë në shtesë në të ardhura personale në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Nëpunësit e Institutit nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejt marrin pjesë në ekzaminimet mjeko ligjore, punojnë me orar të punës prej gjashtë (6) orësh në ditë.

3. NËpunësit e Institutit janë të obliguar që të kryejnë detyrat e kujdestarisë dhe për këtë gëzojnë të drejtën e kompensimit në pajtim me aktin përkatës nënligjor.

KREU III

INSTITUTI PËR MJEKESINË LIGJORE

Neni 14

Themelimi i Institutit

1. Me këtë ligj themelohet Instituti i Mjekësisë Ligjore si organ qendror i administratës shtetërore, në vartësi të Ministrit të Drejtësisë.
2. Instituti ka statusin e personit juridik.
3. Instituti ka shenjën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë.

Neni 15

Veprimtaria e Institutit

1. Instituti është përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në vijim:
 - 1.1. autopsinë mjeko ligjore;
 - 1.2. ekzaminimin klinik mjeko ligjor;
 - 1.3. ekzaminimin e mostrave biologjike, si dhe ekzaminimet tjera mjeko ligjore të parapara me legjislacionin në fuqi;
 - 1.4. mbajtjen e regjistrave të të gjitha rezultateve mjeko ligjore në bazë të urdhrit të gjykatës apo prokurorit të shtetit
 - 1.5. Kërkimi, gjetja dhe zhvarrimi, si dhe përcaktimi i fatit, identifikimi dhe dorëzimi i mbetjeve mortore të personave të pagjetur që ndërlidhen me luftën në Kosovë;
 - 1.6. profesionale, arsimore dhe shkencore hulumtuese në pajtim me ligjin
 - 1.7. Mbajtja e kontaktit me familjet e personave të pagjetur dhe bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare, që janë të përfshira në procesin e zbardhjes së fatit të personave të pagjetur.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, në rastet kur ekzaminimi i caktuar mjekoligjor, duke përfshirë ekzaminimin e profilit gjenetik të ADN-së, i tejkalon kapacitetet e Institutit, këto ekzaminime, me urdhër të Prokurorit të Shtetit apo Gjykatës, bëhen në institucione tjera në pajtim me ligjin.

3. Instituti i Mjekësisë Ligjore harton një raport vjetor që përshkruan punën e tij, duke përfshirë, mes tjerash, numrin e ekzaminimeve të realizuara dhe të dhëna të tjera përkatëse, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atë më së largu deri në muajin mars”.

Neni 16

Struktura organizative e Institutit

Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Institutit, rregullohet me akt të veçantë, të cilin e miraton Ministri i Drejtësisë në pajtim me ligjin për administratë shtetërore. Ky akt përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 17

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit

1. Me Institut udhëheq Drejtori i Përgjithshëm (më tej: Drejtori).
2. Drejtori emërohet në bazë të mënyrës, kushteve dhe procedurës së paraparë me dispozitat për emërimin, në pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Drejtori udhëheqë, dhe përfaqëson Institutin.
4. Për punën e tij Drejtori i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrit të Drejtësisë.

KREU IV

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 18

Dispozitat Kalimtare

1. Ekspertet e EULEX KOSOVA do të punojnë së bashku me autoritetet vendore me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve vendore dhe për të siguruar që Instituti i Mjekësisë Ligjore ka ekspertë të mjaftueshëm të trajnuar mirë që janë në gjendje të ofrojnë ekspertizë mjeko ligjore duke i plotësuar standardet ndërkombëtare dhe praktikatat me të mira evropiane.
2. Me kërkesën e Drejtorit, ekspertët e EULEX KOSOVA do të ofrojnë ekspertizë në çdo lloj të ekzaminimeve mjeko ligjore, përfshirë autopsitë.
3. EULEX KOSOVA në Kosovë do ta nominoj Zëvendës Drejtorin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, i cili do të jetë përgjegjës për angazhimet operacionale të eksperteve të EULEX KOSOVA.
4. Pjesëtarët e Misionit EULEX KOSOVA do të jenë të bashkëvendosur në objektet e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të punësuarit në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, vazhdojnë të punojnë në Institutin e Mjekësisë Ligjore, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Instituti është trashëgues juridik i Departamentit të Mjekësisë Ligjore me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

7. Termi “Departamenti i Mjekësisë Ligjore”, i përmendur në cilindo ligj apo akt nënligjor në fuqi, zëvendësohet me termin “Institutin e Mjekësisë Ligjore”.

Neni 19 **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji do të nxirren brenda gjashtë (6) muajve prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni, zbatohen aktet nënligjore të cilat janë në fuqi, nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 20 **Shfuqizimi**

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë viti IV, Nr. 58 / 10 Gusht 2009) me përjashtim të nenit 8, si dhe Ligji Nr. 03/L-187 për Mjekësinë Ligjore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë viti , Nr. 70 / 31 Maj 2010).

Neni 21 **Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-060
10 mars 2016

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI